



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport,
Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 80

Prishtinë, më 15.05.2013 ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike,
Qeverisje Lokale dhe Media**

Në mbledhje morën pjesë : Idriz Vehapi, Eqrem Kryeziu, Enis Kervan, Xhevahire Izmaaku, Sadri Ferati, Lirije Kajtazi, Teuta Haxhiu, Jeton Svirca, Afrim Kasolli, Ramë Vataj dhe Milivoje Stojanovic.

Në mbledhje morën pjesë : Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë z. Ramë Buja dhe përfaqësues të tjerë nga kjo ministri, zyrtar nga presidenca, përfaqësues të shoqërisë civile dhe zyrtarët për media të Kuvendit.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Lule Ymeri, Shaip Goxhuli dhe Valbona Makolli-praktikante.

Mbledhjen e kryesoi : Idriz Vehapi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit;**
- 3. Shqyrtimi i vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Universiteteve Publike, në Gjakovë, në Gjiçan dhe në Mitrovicë si institucione Publike të Arsimit të Lartë. I ftuar z.Ramë Buja – Ministër i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;**
- 4. Procesi i reformimit të Fakultetit të Edukimit;**
- 5. Shqyrtimi i Projekt-Statutit të Universitetit Publik "Ukshin Hoti" në Prizren;**
- 6. Shqyrtimi i Projekt-Statutit të Universitetit Publik "Haxhi Zeka" në Pejë;**
- 7. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, mbajtur me 20.03.2013

Procesverbali i mbledhjes së Komisionit, mbajtur me 20.03.2013 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Universiteteve Publike, në Gjakovë, në Gjilan dhe në Mitrovicë si institucione Publike të Arsimit të Lartë

Kryetari njoftoi anëtarët e Komisionit se këtë çështje e ka shqyrtuar Kryesia e Kuvendit e cila na ka ngarkuar si Komision funksional që t'i shqyrtojmë vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e universiteteve publike, në Gjakovë, Gjilan dhe Mitrovicë, si institucione publike të arsimit të lartë dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

Ministri Ramë Buja theksoi se vendimet për themelimin universiteteve publike janë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi. Në këto tri qytete tashmë janë njësitë e Universitetit publik të Prishtinës, ndërsa me këto vendime synohet që këto njësi të avancohen në universitete të pavarura, në mënyrë që të rinjve t'iu ofrohet institucionet e arsimit të lartë më afër vendbanimit. Kapacitetet e objekteve për nga funksioni janë në nivel të duhur ndërsa ngarkesa buxhetore për hapjen e Universiteteve është e përballueshme për Republikën e Kosovës.

Kryetari kërkoi që para dërgimit të raportit me rekomandime në senace plenare, ministria të sjellë materiale për fakultetet ekzistuese në këto qytete, lidhur me numrin e studentëve, stafin akademik dhe hulumtimeve që janë bërë me qëllim të prezantimit në seancë plenare.

Teuta Haxhiu mbështeti nismën për themelimin e Universiteteve dhe theksoi se shqetësim është çështja e cilesisë dhe kërkoi që bashkarisht të punojnë që të ketë cilësi në këto universitete si dhe ngriti çështjen e shkeljeve që po bëhen nga kolegjet private.

Eqrem Kryeziu tha se nuk ka presion nga ana e Kryesisë së Kuvendit për themelimin e Universiteteve, kërkoi që këto çështje të mos debatohen shumë dhe kërkoi nga ministria që të sjellë statistika se sa janë të përfshirë të rinjtë kosovarë në studimet universitare në krahasim me vendet e rajonit.

Afrim Kasolli shprehu shqetësim për kapacitetet e këtyre institucioneve në ofrimin e shërbimeve cilësore. Edhe pse numri i studenteve kosovarë i përfshirë në studime universitare është më i ulët në rajon, nuk e përkrahë vendimin e Qeverisë për themelimin e këtyre universiteteve.

Xhevahire Izmaku mbështeti vendimin për themelimin e Universiteteve dhe kërkoi që të përkrahët dhe të monitorohet puna e tyre. Për shkak të gjendjes ekonomike, është mirë që të hapen këto universitete në mënyrë që të rinjve t'iu krijohen kushte më të mira për studime.

Ramë Vataj shpreh shqetësim se hapja e universiteteve është vendim i ngutshëm për shumë arsye. Hapja e tyre duhet të bazohet në hulumtime të mirëfillta, në kritere dhe dyshon që do të ketë cilësi, shpreh shqetësim për mungesë të profesorëve, për koston e financimit dhe është skeptik në funksionimin e tyre.

Jeton Svirca thekson se është pro propozimit të Qeverisë dhe do ta përkrahë themelimin e universiteteve.

Kryetari hap votimin për këtë pikë të rendit të ditës dhe me nëntë vota për dhe dy abstenime nga Ramë Vataj dhe Afrim Kasolli, Komisioni me shumicë votash përkrahu vendimet e Qeverisë së Kosovës për themelimin e tri universiteteve publike në Gjakovë, Gjilan dhe Mitrovicë.

4. Procesi i reformimit të Fakultetit të Edukimit

Kryetari hap diskutimin për vendimin e Ministrisë së Arsimit lidhur me procesin e reformimit të Fakultetit të Edukimit dhe fton ministrin Ramë Buja për sqarime të mëtutjeshme.

Ministri Ramë Buja sqaroi se procesi i reformimit të Fakultetit të Edukimit po bëhet me kërkesë të Komisionit Evropian. Ky vendim ka përkrahjen e Fakultetit të Edukimit dhe fakulteteve të tjera të Universitetit të Prishtinës. Sugjerimi i Komisionit Evropian ka qenë që pas përfundimit të studimeve themelore kandidati duhet ti realizojë edhe 120 kredi në sferën e pedagogjisë dhe metodikës në mënyrë që ministria t'a licencojë kandidatin si mësimdhënës.

Kryetari kërkoi që baza e studimeve të jetë në fakultetet përkatëse në mënyrë që të mos ketë duplikim të programeve të studimit.

Teuta Haxhiu theksoi se reforma duhet të ndodhë dhe kërkoi sqarim lidhur me atë se a duhet të gjithë mësimdhënësit si në shkolla fillore ashtu dhe të mesme të kenë gjithsej 120 kredi në sferën e pedagogjisë dhe metodikës dhe kërkoi sqarim nga ministri për vendimin e Agjencinit për Akreditim për mbylljen e disa degëve në kolegjet private dhe çka do të ndodh me studentët në ato kolegje.

Ministri Ramë Buja sqaroi se me këtë vendim, për t'u licencur mësimdhënës në sistemin arsimor fillor dhe të mesëm kandidatët duhet t'i përfundojnë 120 kredi në pedagogji dhe metodikë. Ndërsa sa i përket shqetësimeve për mbylljen e disa degëve në kolegjet private theksoi se ato janë rekomandime profesionale dhe të pavarura të Agjencisë për Akreditim dhe ministria merr vendim në bazë të rekomandimeve nga ky Agjencion.

Ramë Vataj nuk e përkrahë këtë vendim të ministrisë, dhe ceku se transformimi i tillë shkakton kaos në sistemin arsimor duke detyruar studentët që pas tre viteve studimi në bachelor të përfundojnë edhe dy vite të tjera në Fakultetin e Edukimit. Nuk ka staf të mjaftueshëm për këtë reformë dhe programet që ofrohen në këto dy vite studimi nuk aftësojnë asgjë më shumë studentët që përfundojnë tre vite bachelor.

Kryetari kërkoi që ministria të ketë në fokus punën e fakulteteve dhe të mbikëqyr punën e tyre. Në pajtim me anëtarët e Komisionit dhe ministrisë u vendos që kjo çështje të diskutohet përsëri në mbledhjen tjetër.

5 – 6. Shqyrtimi i Projekt-Statutit të Universitetit Publik "Ukshin Hoti" në Prizren Shqyrtimi i Projekt-Statutit të Universitetit Publik "Haxhi Zeka" në Pejë

Kryetari theksoi se grupi punues ka shqyrtuar këto Projekt-Statute dhe ka paraqitur para anëtarëve të Komisionit propozim-ndryshimet në këto dy dokumente.

Ramë Vataj theksoi se grupi punues ka punuar së bashku me përfaqësues të MASHT dhe dy universiteteve në fjalë dhe ka dhënë propozimet të cilat vlerëson se janë të arsyeshme dhe fton anëtarët e Komisionit t'i përkrahin këto propozim-ndryshime.

Afrim Kasolli i përkrahë propozimet e bëra në Projekt-Statute por nuk i përkrahë Projekt-Statutet në tërësi dhe abstenoj gjatë votimit.

Enis Kervan theksoi se në emër të Grupit Parlamentar 6+ nuk e përkrahë propozimin e grupit punues për ndryshimin e nenit 2 paragrafi 2.4 të Projekt-Statutit të Universitetit Publik "Ukshin Hoti" në Prizren.

Pas diskutimeve, projekt - statuti i Universitetit Publik "Ukshin Hoti" në Prizren u miratua me shumicë votash, abstenoj deputeti Afrim Kasolli dhe deputeti Enis Kervan ndërsa projekt-statuti i Universitetit Publik "Haxhi Zeka" në Pejë u miratua më shumicë votash, abstenoj deputeti Afrim Kasolli.

Mbledhja përfundoi në ora 13:00

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**KRYETARI I KOMISIONIT,
Idriz Vehapi**